# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6392
E premte, 20 gusht 2021
çmimi 0.40 €


## Osmani: Jemi të hapur për t'i mirëpritur qytetarët nga Afganistani

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ FAQE 4-5

# MËSIMDHËNËSIT, TË GATSHËM TA NISIN MËSIMIN NË OBJEKTET SHKOLLORE




Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se mësimdhënësit janë të gatshëm që vitin e ri shkollor ta nisin në objektet shkollore. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është rritur numri i mësimdhënësve të vaksinuar. Jasharaj është shprehur i bindur se deri në fillim të shtatorit pjesa dërrmuese e punëtorëve të arsimit do të vaksinohen me dozën e parë të vaksinës kundër Covidit. Sa i përket përgatitjes së institucioneve për fillimin e këtij viti shkollor, ai ka thënë se e vërteta e këtyre përgatitjeve do të dihet shumë shpejt

SOT (E PREMTE) HYJNË NË FUQI MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT NË KOSOVË

## Gjendje alarmante, tetë të vdekur dhe 2 236 raste të reja me Covid

Situata epidemiologjike në Kosovë është përkeqësuar ditët e fundit. Kemi rritje të numrit të të vdekurve dhe të rasteve të reja me Covid. Vetëm të enjten tetë qytetarë kanë humbur jetën nga ky virus, ndërkaq janë konfirmuar edhe 2 236 raste të reja. Institucionet shëndetësore në vend kanë bërë thirrje për respektim të masave të reja dhe për marrjen e vaksinës kundër Covidit FAQE 3



## AKTUALE



### ABDIXHIKU TAKON ZAEVIN NË SHKUP, DISKUTOJNË PËR ZHVILLIMET E FUNDIT POLITIKE NË RAJON F. 3

### SHALA: MINISTRIA E ARSIMIT PO E DËSHTON EDHE NJË VIT TË RI SHKOLLOR F. 3

### SHBA-ja DO TË DËRGOJË KËTË JAVË VAKSINA KUNDËR COVID-19 NË KOSOVË F. 3

## EKONOMI



### MURATI: MBI 10 MILIONË EURO JANË INVESTUAR NË BONOT E DIASPORËS F. 8

## SPORT



### FILLON RESTAURIMI I SHTËPISË NË KOMPLEKSIN E BANIMIT EMINGJIKU F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Osmani: Jemi të hapur për t'i mirëpritur qytetarët nga Afganistani



PRISHTINE, 19 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim një delegacion i përbërë nga Ulrika Richardson, koordinatore e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Erol Arduc nga UNHCR-ja dhe Anna Rostocka nga IOM, me të cilët ka diskutuar për përgatitjet e Kosovës për sistemimin e qytetarëve nga Afganistani në kuadër të Programit të Posaçëm të Vizave për Migrim të ShBA-së.

Përfaqësuesit e të tri organizatave kanë falënderuar presidenten Osmani për gatishmërinë e shtetit të Kosovës për strehimin e qytetarëve nga Afganistani dhe në të njëjtën kohë kanë ofruar mbështetje ndaj institucioneve të Kosovës për t'u dalë në ndihmë të strehuarve.

Presidentja Osmani ka përsëritur se Kosova është e hapur për qytetarët nga Afganistani. "Ne jemi të hapur për t'i mirëpritur qytetarët nga Afganistani, sepse askush më mirë se ne nuk e njeh dhimbjen e tyre. Për më tepër, këtë po e bëjmë bashkë me aleatin tonë strategjik - ShBA-në", ka theksuar presidentja Osmani.

# Biden: Nuk besoj që talebanët kanë ndryshuar



UASHINGTON, 19 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se ai nuk beson se talebanët kanë ndryshuar dhe se, sipas tij, ata tani po kalojnë nëpër një "krizë ekzistenciale" lidhur me atë nëse duan legjitimitet në skenën botërore pasi morën pushtetin në Afganistan.

Kur u pyet gjatë intervistës për ABC, a beson që talebanët kanë ndryshuar, presidenti Biden u përgjigj: "Jo". "Mendoj se ata po kalojnë nëpër një krizë ekzistenciale lidhur me atë nëse duan që të njihen nga komuniteti ndërkombëtar si qeveri legjitime. Nuk mendoj se ata duan një gjë të tillë", tha Biden.

Fuqitë perëndimore po përballen me vendimin se a duhet të merren me talebanët, të cilët i kanë luftuar për pothuajse 20 vjet, pasi militantët më 15 gusht morën nën kontroll Kabulin, pas një ofensive të shpejtë ushtarake, ku morën nën kontroll shumicën e provincave afgane. Marrja nën kontroll e Afganistanit nga talebanët ka rritur frikën se grupi fundamentalist do ta rikthejë udhëheqjen brutale.

Liderët talebanë kanë thënë se ata duan paqe dhe një qeveri gjithëpërfshirëse – në suaza të parimeve të islamit. Ata, po ashtu, janë zotuar se nuk do të hakmerren ndaj kundërshtarëve dhe do të respektojnë të drejtat e grave, bazuar në ligjin islam.

Presidenti amerikan Biden tha se kërcënimi nga al-Kaida dhe organizatat e lidhura me të "është më i madh në pjesë të tjera të botës sesa në Afganistan", duke shtuar se bota nuk mund të injorojë "problemet në horizont" që paraqesin bashkëpunëtorët e al-Kaidës në Siri dhe në Afrikën Lindore, ku ai tha se kërcënimi për Shtetet e Bashkuara "është dukshëm më i madh".

Biden, po ashtu, u pyet edhe për shqetësimet lidhur me trajtimin e grave dhe vajzave në Afganistan dhe ai tha se forca ushtarake nuk është përgjigjja për këtë çështje. "Ideja që ne të jemi në gjendje ta rregullojmë çështjen e të drejtave të grave në mbarë botën përmes forcës ushtarake nuk është ide racionale. Ka shumë vende të botës ku gratë shtypen. Mënyra se si duhet ta trajtojmë këtë çështje është që të bëjmë presion ekonomik, diplomatik dhe ndërkombëtar mbi ta, në mënyrë që ata ta ndryshojnë sjelljen", tha Biden.

Sipas Ligjit të Sheriatit, që talebanët imponuan kur udhëhoqën Afganistanin nga viti 1996 deri më 2001, grave dhe vajzave iu ndalua shkollimi dhe punësimi.

Po ashtu, gratë dhe vajzat ishin të detyruara që të mbuloheshin plotësisht gjatë daljes në publik dhe nuk mund të dilnin nga shtëpia pa shoqërinë e një të afërmi mashkull. Më 18 gusht Bideni, po ashtu, ka thënë se forcat amerikane mund të qëndrojnë në Kabul edhe përtej 312 gushtit, që është data kur trupat amerikane duhet të tërhiqen nga Afganistani. Qëndrimi më i gjatë në Kabul mund të ndodhë me qëllim që të evakuohen të gjithë shtetasit amerikanë.

# Greqia në gjendje gatishmërie për të parandaluar një krizë të re migrantësh

ATHINË, 19 GUSHT - Forcat kufitare në Greqi janë në gjendje gatishmërie me qëllim që të parandalohet një krizë migrantësh siç ndodhi më 2015, tha qeveria greke të enjten. Këto deklarata të zëdhënësit të Qeverisë së Greqisë vijnë teksa pushtetin në Afganistan e kanë marrë talebanët. Greqia ishte në vijën e parë të krizës me migrantë në Evropë më 2015, kur pothuajse një milion persona, që ikën nga konfliktet në Siri, Irak dhe Afganistan, arritën në ishujt grekë. Për dallim nga shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian, Greqia është e shqetësuar se zhvillimet e fundit në Afganistan mund të nxisin një krizë të re të migrantëve, në përmasa të njëjta sikurse në vitin 2015, dhe po kërkon që BE-ja të dalë me një qëndrim të përbashkët për këtë çështje. "Të gjitha forcat në kufij janë në gjendje gatishmërie. Ne nuk do të lejojmë që të përsëriten skenat e vitit 2015", tha zëdhënësi i qeverisë greke, Yannis Economou, në një konferencë për media.



Ministria e Jashtme greke po koordinon veprimet për të sjellë në Greqi tetë shtetas afganë që kanë bashkëpunuar me forcat greke, shtoi ai. "Ne nuk do të ndalemi derisa t'i sjellim ata në Greqi", tha Economuo.

Më 15 gusht kryeqyteti afgan, Kabul, ra në duart e talebanëve, teksa presidenti afgan, Ashraf Ghani, u largua nga vendi.

Mijëra afganë po tentojnë të largohen nga vendi nga frika e talebanëve.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

SOT (E PREMTE) HYJNË NË FUQI MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT NË KOSOVË

# Gjendje alarmante, tetë të vdekur dhe 2 236 raste të reja me Covid

Situata epidemiologjike në Kosovë është përkeqësuar ditët e fundit. Ka rritje të numrit të të vdekurve dhe të rasteve të reja me Covid. Vetëm të enjten tetë qytetarë kanë humbur jetën nga ky virus, ndërkaq janë konfirmuar edhe 2 236 raste të reja. Institucionet shëndetësore në vend kanë bërë thirrje për respektim të masave të reja dhe për marrjen e vaksinës kundër Covidit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten se, sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, prej 11 373 testimeve, 2 236 qytetarë kanë dalë pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar tetë raste të të vdekurve. Të enjten janë shëruar edhe 138 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 106 546. Në total numri i rasteve aktive është 14 249.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 22 119 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 644 212 doza të vaksinës. Deri më sot 221 026 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Në Kosovë është rritur numri i personave që po trajtohen me oksigjeno-terapi. Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të enjten se janë 470 pacientë që po trajtohen përmes kësaj metode derisa një ditë më herët ishte raportuar për 418.

Në bazë të raportit ditor të ShSKUK-s, 626 pacientë janë të shtrirë në klinikat Covid-19 dhe spitalet e përgjithshme, prej tyre 527 janë të konfirmuar pozitivë në Covid-19, ndërsa 26 janë në gjendje të rënduar shëndetësore.

Situata epidemiologjike në Kosovë është përkeqësuar që nga fundi i muajit korrik.

Qeveria e Kosovës një ditë më parë ka miratuar masat e reja për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, të cilat më 20 gusht hyjnë në fuqi dhe vlejnë deri më 1 shtator.

Shërbimet e gastronomisë, përfshirë restorantet dhe hapësirat e ngjashme në hoteleri, lejohen të punojnë deri në orën 22:30 dhe duhet ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me udhëzuesin përkatës. Në hapësirat e mbyllura lejohet veprimtaria deri në 50 për qind e kapacitetit të hapësirës. Në hapësirat e hapura lejohet shfrytëzimi deri në 70 për qind e kapacitetit të hapësirës. Përgjegjësit e lokaleve duhet të sigurohen që distanca ndërmjet klientëve në tavolina të ndryshme të jetë së paku një metër.

Nga data 20 gusht deri më 1 shtator 2021 ndalohet veprimtaria e klubeve të natës, dasmave, fejesave, ahengjeve familjare dhe mbrëmjeve të maturës në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.



Me masat e reja ndalohet hyrja në ambientet e mbyllura pa maskë. "Bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën është obligative në të gjitha rastet, përveç: Gjatë ecjes në ambient të jashtëm vetëm; Gjatë ngasjes së automjetit vetëm, apo në grup me jo më shumë se katër persona; Gjatë vrapimit, çiklimit dhe ushtrimeve fizike; Gjatë ngrënies apo pijes", thuhet në vendimin e qeverisë.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se distanca fizike, maskat dhe higjiena personale janë të domosdoshme, por detyrë mbi çdo detyrë për të gjithë ne si qytetarë të përgjegjshëm të Republikës së Kosovës është vaksinimi. Ai ka thënë se varianti "Delta" i virusit korona tanimë është varianti dominues në Kosovë. "Ashtu siç është parë edhe në botë, kjo valë është më dramatike se secila valë tjetër për shkak të përhapjes shumë të shpejtë të virusit. Vaksinimi është e vetmja mënyrë për të parandaluar. Sipas raporteve që kemi, asnjë të vdekur nuk e kemi nga ata që janë vaksinuar. Kemi shumë pak të hospitalizuar nga ata që janë vaksinuar dhe të hospitalizuarit e vaksinuar po e përballojnë shumë më lehtë", ka thënë Kurti.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar se varianti "Delta" po vazhdon të përhapet me shpejtësi në Kosovë. Sipas këtij instituti, masat rigoroze të ndërmarra dhe zbatimi i tyre duhet të bëhet nga çdo qytetar i Republikës. "Bashkë me masat tashmë të njohura: bartja e maskave, mbajtja e distancës dhe mbajtja e higjienës, do të arrijnë efektin e vet në uljen e lakores. Ju lutemi të besoni se masa më efikase në luftë kundër Covid-19 është vaksinimi!", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Çitaku: Nëse vazhdon ky trend, mbyllja do të jetë e pashmangshme

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka komentuar situatën me pandeminë në vendin tonë. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se gjendja me pandeminë në Kosovë është alarmante. Çitaku ka thënë nëse vazhdon ky trend, atëherë mbyllja do të jetë e pashmangshme. "2 236 të infektuar sot. Gjendja është alarmante. Nuk po shohim askund në dritë përpjekje për decentralizim dhe thjeshtëzim të procesit të vaksinimit. Nëse vazhdon ky trend, mbyllja do të jetë e pashmangshme. E votat, nuk kanë me na vy askujt", ka shkruar Çitaku në llogarinë e saj në "Facebook".

## ShBA-ja do të dërgojë këtë javë vaksina kundër Covid-19 në Kosovë

Shtetet e Bashkuara po dërgojnë këtë javë në Kosovë një kontingjent prej 35 100 vaksinash kundër Covid-19, i tha "Zërit të Amerikës" një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë. Ai tha se vaksinat dërgohen përmes programit Covax dhe janë pjesë e angazhimit të Shteteve të Bashkuara për të luajtur një rol udhëheqës në luftën për t'i dhënë fund pandemisë kudo në botë. Dozat për Kosovën janë pjesë e një blerjeje prej gjysmë miliardi të vaksinës "Pfizer" të siguruara nga presidenti Joe Biden në fillim të kësaj vere.

Ky zyrtar ka theksuar se ekipet shkencore dhe autoritetet ligjore të të dyja vendeve kanë punuar së bashku për ta siguruar shpërndarjen e shpejtë dhe efektive të vaksinave në Kosovë. "Ne jemi krenarë që jemi në gjendje t'i dorëzojmë këto vaksina të sigurta dhe efektive për njerëzit e Kosovës. Ne po i ndajmë këto doza jo për të siguruar favore ose për të nxjerrë koncesione. Vaksinat tona nuk vijnë me prapavijë. Ne po e bëjmë këtë me synimin e vetëm për të shpëtuar jetë", ka thënë ai.

# Abdixhiku takon Zaevin në Shkup, diskutojnë për zhvillimet e fundit politike në rajon

SHKUP, 19 GUSHT (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku është pritur të enjten në Shkup nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Abdixhiku gjatë kësaj vizite ishte i shoqëruar edhe nga nënkryetari Lutfi Haziri. Në këtë takim në mes të Abdixhikut dhe Zaevit është diskutuar perspektiva e dy vendeve fqinje, zhvillimet e fundit politike në rajon, si dhe bashkëpunimet partiake në mes të përfaqësuesve politikë të Kosovës e të Maqedonisë Veriore në vazhdimësi.

Abdixhiku dhe Zaevi theksuan se dy vendet, si dy shtete të afërta, duhet të ruajnë e kultivojnë partneritetin dhe bashkëpunimin ndërshtetëror.

Në takim kryetari i LDK-së, Abdixhiku, ka ritheksuar se çdo bashkëpunim ekonomik rajonal nuk mund të jetë i plotë pa përfshirjen e të gjithë shteteve të Ballkanit Perëndimor, edhe më pak pa përfshirjen e Bashkimit Evropian.

Ai ka thënë se, mbi të gjitha, bashkëpunimi ekonomik duhet të paraprihet nga pranimi i realitetit politik si parakusht i një rajoni prosperues.

Palët u pajtuan t'i vazhdojnë takimet e komunikimet e hapura dhe të drejta.






FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ

# Mësimdhënësit, të gatshëm ta nisin mësimin në objektet shkollore

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se mësimdhënësit janë të gatshëm që vitin e ri shkollor ta nisin në objektet shkollore. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është rritur numri i mësimdhënësve të vaksinuar. Jasharaj është shprehur i bindur se deri në fillim të shtatorit pjesa dërrmuese e punëtorëve të arsimit do të vaksinohen me dozën e parë të vaksinës kundër Covidit. Sa i përket përgatitjes së institucioneve për fillimin e këtij viti shkollor, ai ka thënë se e vërteta e këtyre përgatitjeve do të dihet shumë shpejt

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 GUSHT -

**"Epoka e re":** *Z. Jasharaj, MAShTI ka paralajmëruar se fillimi i vitit të ri shkollor do të fillojë më 1 shtator. A janë bërë përgatitjet e duhura për fillimin e këtij viti shkollor?*

**Jasharaj:** SBAShK-u, pas publikimit fillestar në media për numrin e vogël të të vaksinuarve nga sektori i arsimit, pjesën më të madhe të angazhimeve i ka kushtuar çështjes së vaksinimit. Pasi kemi marrë informatat se ishin të vogla shifrat e të vaksinuarve, kemi dalë me apelin publik drejtuar anëtarësisë sonë që të vaksinohet. Të njëjtin apel e kemi përsëritur pas takimit me ministren Nagavci dhe i falënderojmë publikisht punëtorët e arsimit, sepse ata e përfillën apelin tonë dhe numri i të vaksinuarve në sektorin e arsimit sa vjen e shtohet dhe besojmë shumë se deri në fillim të shtatorit pjesa dërrmuese e punëtorëve të arsimit do të jenë të vaksinuar me dozën e parë e një numër i madh i tyre edhe me dozën e dytë të vaksinës. Në takimin që kishim këtë të martë me grupin punues të MAShTI-t lidhur me Udhëzimin Administrativ për kalendarin shkollor për vitin e ri shkollor, na është thënë se ata konsiderojnë, bazuar në raportet e drejtorive arsimore, se janë bërë përgatitjet e duhura për nismë të mbarë të vitit të ri shkollor dhe urojmë të jetë kështu. Por, nga praktikat e viteve të kaluar, ka DKA që gjendjen nuk e paraqesin reale. Ne nga e hëna do të mbledhim shënime të sakta nga kryetarët e shoqatave sindikale nga të gjitha shkollat e Kosovës dhe nga kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe do të bazohemi në ato informata sepse gjithmonë kanë qenë korrekte dhe të sakta, pastaj në bazë të tyre edhe do të dalim publikisht lidhur me atë sa janë përgatitur institucionet arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor. Institucionet duhet ta kenë të qartë se përgatitjet që janë bërë në të kaluarën, kur nuk kemi pasur probleme shtesë me Covidin, nuk janë të mjaftueshme nëse nuk janë bërë përgatitje dhe angazhime shtesë, ngaqë tani versioni i ri i Covidit, pra "Delta", po prek edhe fëmijët dhe moshat e reja, që në vitin e kaluar shkollor nuk ishte kështu, prandaj përgatitjet duhet të jenë maksimale. SBAShK-u është angazhuar dhe vazhdon të angazhohet për ta mobilizuar anëtarësinë për vaksinim të plotë dhe për t'u përgatitur për procesin mësimor, por edhe të tjerët duhet të jenë në nivel të angazhimeve.

E vërteta se a janë dhe sa janë të përgatitura institucionet arsimore për të filluar mbarë viti i ri shkollor do të dalë shpejt →

në shesh. Neve na gëzon fakti se punëtorët e arsimit kanë dëgjuar apelin tonë dhe është shtuar shumë numri i të vaksinuarve. Po ashtu, krenohemi me gatishmërinë e tyre që mësimin ta nisin në objekte shkollore. Janë të tjerët ata që është dashur ta kryejnë obligimin e tyre dhe e kanë obligim edhe ta raportojnë gjendjen reale të përgatitjeve pa bërë zbukurime. Kishte tendenca që të krijohet në opinion "fajtori kujdestar" nëse do të ketë telashe me fillimin e vitit të ri shkollor, duke u thirrur vazhdimisht në numrin e vogël të punëtorëve arsimorë të vaksinuar, por anëtarësia e SBAShK-ut ua heshti këtë tendencë sepse numri i të vaksinuarve sa vjen e shtohet dhe ne i përgëzojmë dhe i falënderojmë që e kanë dëgjuar apelin tonë. Këtë gjë e kemi pritur sepse e kemi krijuar me punë dhe përkushtim, besim dhe respekt të ndërsjellë.

**"Epoka e re":** *Sa janë të përgatitur mësimdhënësit për fillimin e këtij viti shkollor?*
**Jasharaj:** Punëtorët arsimorë në përgjithësi janë të përgatitur për ta nisur vitin e ri shkollor. Ata tanimë janë duke u paraqitur në institucione arsimore dhe janë duke bashkëbiseduar për detyrat konkrete. Ata edhe në vitin e kaluar mësimor, por edhe tani janë këmbëngulës që procesi mësimor të zhvillohet në institucione arsimore pavarësisht prej vështirësive tepër të mëdha që ka krijuar pandemia. SBAShK-u i përgëzon për këtë duke u premtuar se, si në të kaluarën, edhe tani e gjithmonë do të jetë zë i tyre dhe do të vazhdojë angazhimet për t'i realizuar kërkesat legjitime të tyre.

**"Epoka e re":** *Opozita ka thënë se nuk janë bërë përgatitjet e duhura dhe se po rrezikohet edhe ky vit shkollor. Cili është qëndrimi juaj për këto kritika?*
**Jasharaj:** Opozita ka qëndrimit e veta dhe misionin e vet. Unë besoj se opozita deklarimet dhe vlerësimet e veta është në gjendje edhe t'i argumentojë para opinionit. Fillimi shtatori do të tregojë të vërtetën dhe uroj që të jenë bërë përgatitjet e duhura dhe të kemi rrjedhë të mbarë të procesit mësimor.

**"Epoka e re":** *Keni ndonjë statistikë se sa mësimdhënës janë vaksinuar deri më tani?*
**Jasharaj:** Ministra e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik me siguri i jep të dhëna konkrete MAShTI-t. Pra, ata dinë sakë rrjedhën e vaksinimit edhe në sektorin e arsimit. Deklaratat e ministres Nagavci janë optimiste se procesi i vaksinimit të punëtorëve arsimorë ka rrjedhë të mbarë dhe se numri i të vaksinuarve sa vjen e shtohet.

**"Epoka e re":** *Cili është mesazhi juaj për mësimdhënësit që po hezitojnë të vaksinohen kundër Covidit?*
**Jasharaj:** Unë dhe stafi qendror jemi vaksinuar me të dyja dozat dhe këtë e kemi bërë që të jemi të mbrojtur dhe të jemi në nivel të angazhimeve në shërbim të anëtarësisë. U bëjmë thirrje edhe punëtorëve arsimorë që nuk janë vaksinuar ende, që këtë obligim ta kryejnë dhe kështu të jenë të mbrojtur, njëkohësisht t mbrojnë familjen dhe nxënësit. Vaksinimi tanimë është obligim dhe punëtorët arsimorë u dëshmuan edhe në të kaluarën me unitet e përkushtim në misionin e tyre të shenjtë për edukimin e brezave. Me nder ia dolëm ta kryejmë këtë mision edhe në vitet e okupimit duke u përballur me forcat e pushtuesit, pra me një armik të arsimit që dukej. Unik dhe të vendosur do të përballemi suksesshëm tani me një armik që nuk shihet dhe kështu do ta kryejmë me nder misionin tonë të shenjtë për edukimin dhe arsimimin e brezave.

# Shala: Ministria e Arsimit po e dështon edhe një vit të ri shkollor




EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 GUSHT - Anëtari i Kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Muzafer Shala, në një konferencë për media, ka akuzuar Ministrinë e Arsimit se ka dështuar t'i bëjë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor me kohë, krahas situatës së rënduar nga përballja me pandeminë Covid-19 dhe rritjes së numrit të rasteve të të infektuarve me virusin "Delta".
Shala ka thënë se për PDK-në është jashtëzakonisht e papranueshme, zhgënjyese dhe dështim fund e krye i qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit që nuk ka arritur t'i bëjë përgatitjet e duhura që viti i ri shkollor të fillojë më 1 shtator. "Për dallim nga shumë vende që i përditësojnë të dhënat e udhëzimeve administrative dhe udhëzuesve rreth përgatitjeve të mbarëvajtjes së arsimit, në Kosovë nuk ka ndodhur ende një gjë e tillë nga MAShTI. Në këto çaste kur po flasim, situata në terren është alarmuese dhe shumë drejtorë shkollash që kemi pyetur thonë se askush nuk i ka kontaktuar për asgjë", ka thënë ai.
Shala ka ngritur një sërë shqetësimesh në lidhje me këtë situatë dhe ka kritikuar qeverinë dhe Ministrinë e Arsimit duke thënë se në vend të përgatitjeve intensive, ata e kaluan pushimin veror në bregdet dhe sallone dasmash dhe rrezikojnë të dështojnë edhe një vit të ri shkollor. "I bëjmë apel Ministrisë së Arsimit dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse që ta marrin seriozisht situatën me pandeminë dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Në të kundërtën, dështimi i qeverisë do të zbehë besimin e mësuesve, nxënësve dhe prindërve në sistemin arsimor të vendit tonë në këtë krizë pandemie. Duhet që të arrihet një konsensus me të gjitha palët e interesit për ta tejkaluar këtë krizë dhe ministria të jetë konsistente me vendimet që i merr duke i informuar të gjitha palët për përgatitjet sa më herët dhe në mënyrë të duhur", ka deklaruar Shala.

## Podujeva bëhet edhe me një QMF të re



**Podujevë, 19 gusht (ER) -** Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e Kuwait Society For Relief Kosovo, Shaqir Shaqiri, për ndërtimin e një qendre të mjekësisë familjare në Podujevë, e ku i pranishëm ishte edhe drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Driton Veliu. Ky është donacion nga kjo organizatë për komunën e Podujevës në vlerë të 124 mijë eurove dhe objekt me sipërfaqe 300 metra katrorë.
Kryetari Bulliqi u shpreh i lumtur për këtë projekt dhe falënderoi donatorin. "Jam i lumtur për jetësimin e këtij projekti i cili ndikon në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në komunën tonë" , ka thënë kryetari Bulliqi.

# Filloi asfaltimi i dy rrugëve në Ngucat të Malishevës



**Malishevë, 19 gusht (ER) -** Në kuadër të realizimit të investimeve kapitale, përkatësisht të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në vendbanimet e komunës së Malishevës, të enjten ka filluar asfaltimi i dy rrugëve në fshatin Ngucat, me gjatësi prej 630 metrash, në të dy rrugët e lagjeve.
Asfaltimin e rrugëve e kanë parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori komunal për urbanizëm, Ahmet Morina, të cilët janë pritur nga kryetari i fshatit, Mefail Elshani, si dhe aktivistë e banorë të tjerë të fshatit.
Nënkryetari Berisha i ka uruar banorët për asfaltimin e këtyre dy rrugëve në fshat. "Rregullimi i infrastrukturës rrugore në të gjitha vendbanimet e komunës së Malishevës pothuajse është i përfunduar dhe tani po investojmë në rrugët brenda lagjeve, por gjithsesi këto janë kërkesa dhe nevoja të banorëve të cilat ne jemi duke i realizuar dhe jemi të përkushtuar për realizimin e të gjitha projekteve dhe planifikimeve për këtë vit", ka thënë Berisha.
Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, ka bërë me dije se këto dy rrugë kanë një gjatësi prej rreth 630 metrave dhe rregullimi dhe asfaltimi i tyre mundësohet nga buxheti i komunës së Malishevës.
Kryetari i fshatit, Elshani dhe banorët e kanë falënderuar komunën e Malishevës për këtë investim dhe për investimet e tjera në fshatin Ngucat.

# Fillon restaurimi i shtëpisë në kompleksin e banimit Emingjiku



**Prishtinë, 19 gusht (ER) -** Ndërtesa kryesore në kompleksin e banimit Emingjiku ka filluar të restaurohet gjatë vitit 2017. Pas një ndërprerjeje gati katërvjeçare, kanë filluar ndërhyrjet restauruese në këtë ndërtesë. Gjatë muajit maj të këtij viti, pas vlerësimit të bërë nga Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore rreth gjendjes dhe integritetit të vlerave të trashëgimisë kulturore të kësaj ndërtese, plani i ndërhyrjeve restauruese është plotësuar me masat e sigurisë teknike. Ky plan i kompletuar do të fillojë të zbatohet nën mbikëqyrjen e rregullt të institucioneve të trashëgimisë kulturore. Sigurimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe monitorimi sistematik paraqet njërin prej prioriteteve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prandaj jemi të përkushtuar në përmirësimin e gjendjes së kësaj trashëgimie. Punimet do të kryhen nga kompania "Pleqja", nën mbikëqyrjen e stafit profesional nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

## Komuna e Prishtinës vazhdon realizimin e testeve rapide për Covid-19



Prishtinë, 19 gusht (ER) - Komuna e Prishtinës do të vazhdojë realizimin e testeve rapide për Covid-19, nga data 20 gusht 2021, në Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. 7 në Emshir. Orari i punës do të jetë shtatë ditë në javë, nga ora 08:00-15:30. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, u ka bërë thirrje qytetarëve për vaksinim dhe për respektimin e masave mbrojtëse nga Covid-19.

# Bahtiri: Mitrovica i ka tejkaluar sfidat më të mëdha të paqes, stabilitetit dhe sigurisë

Faton DËRMAKU

MITROVICË, 19 GUSHT - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe nënkryetari Faruk Mujka, kanë pritur të enjten në takim shefin e Zyrës Rajonale të UNMIK-ut në Mitrovicë, Preston Hiroki Pentony, të shoqëruar nga zëvendësshefja e Zyrës Rajonale e UNMIK-ut në Mitrovicë, Sandra Imshiroviq, me të cilët ka biseduar për situatën e sigurisë si dhe për zhvillimet aktuale në komunë.

Bahtiri ka falënderuar përfaqësuesit e UNMIK-ut për interesimin e tyre për Mitrovicën dhe për bashkëpunimin e deritashëm të suksesshëm. Ai u ka thënë të papranishmëve se që nga ardhja në krye të komunës së Mitrovicës ka punuar me përkushtim të madh dhe angazhim të pandërprerë për ta stabilizuar gjendjen e përgjithshme në Mitrovicë, duke qenë i vetëdijshëm se pa stabilitet dhe qetësi nuk ka as zhvillim ekonomik. “Falë mbështetjes së të gjithë përfaqësuesve të cilët janë me misione të ndryshme në Kosovë dhe falë përpjekjeve dhe vetëdijesimit të qytetarëve të të gjitha përkatësive etnike, ne kemi arritur që Mitrovicën ta bëjmë një qytet stabil dhe një qytet i cili është ndër më të sigurtit në vend. Kjo shihet edhe nga rënia e madhe e të gjitha incidenteve, posaçërisht të atyre ndëretnike, ku gjatë këtyre viteve të qeverisjes sime janë shënuar një numër jashtëzakonisht i vogël i incidenteve ndëretnike”, ka thënë Bahtiri.

Shefi i Zyrës Rajonale të UNMIK-ut në Mitrovicë, Preston Hiroki Pentony, pasi e ka falënderuar kryetarin Bahtiri për bashkëpunim dhe pasi e ka përgëzuar për punën e mirë, ka thënë se në Mitrovicë ka qenë edhe para se të bëhet shef i zyrës, andaj i vjen mirë kur tani sheh ndryshime të shumta pozitive. Ai ka folur edhe për situatën lidhur me pandeminë e shkaktuar nga virusi Covid-19, me ç’rast kryetari Bahtiri e ka njoftuar Pentony se në Mitrovicë aktualisht janë të vaksinuar afër 28 mijë qytetarë dhe ka një rritje të interesimit të qytetarëve për t’u vaksinuar andaj shpreson që deri në fund të këtij viti do të vaksinohen mbi 65 për qind e qytetarëve, në mënyrë që të krijohet edhe imunitet i popullatës në raport me këtë lloj të virusit.

Bahtiri ka thënë në vazhdim se Mitrovica tanimë i ka tejkaluar sfidat më të mëdha të paqes, stabilitetit dhe sigurisë, prandaj i tërë fokusi i institucioneve lokale është drejtuar në zhvillimin ekonomik, ku edhe janë shënuar rezultate të kënaqshme.

Në fund të takimit të dyja palët shprehën gatishmëri dhe vullnet për bashkëpunim të mëtutjeshëm midis komunës së Mitrovicës dhe UNMIK-ut.



# Mehaj kërkon nga homologu ukrainas, gjeorgjian dhe azerbajxhanas njohjen e Kosovës



PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë qëndrimit të tij në Turqi, është ftuar në drekë pune nga nikoqiri, ministri i Mbrojtjes Kombëtare i Turqisë, Hulusi Akar, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Turke, gjeneral Yasar Guler. Pjesëmarrës në këtë rast ka qenë ministri i Mbrojtjes i Ukrainës, i Gjeorgjisë, i Azerbejxhanit dhe i Libisë.

Në këtë takim është diskutuar për mjedisin e sigurisë globale si dhe për kërcënimet dhe rreziqet që e cenojnë këtë mjedis, krahas mekanizmave për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit të përgjithshëm.

Ndër të tjera, ministri Mehaj ka kërkuar nga ministri i Ukrainës, i Gjeorgjisë dhe i Azerbejxhanit, që nga autoriteti i tyre të shprehin ndikimin e duhur në qeveritë dhe autoritetet politikëbërëse dhe vendimmarrëse të shteteve të tyre, për njohjen sa më të shpejtë të Republikës së Kosovës dhe për vendosjen e marrëdhënieve ndërshtetërore në të gjitha fushat.

## Vetëvendosje në Shqipëri proteston kundër Bregoviqit: ‘Bregoviq dajre gjenocidi’

TIRANË, 19 GUSHT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje, Qendra në Shqipëri, ka realizuar të enjten një aksion simbolik kundër pjesëmarrjes së muzikantit serb Goran Bregoviq, në Festivalin e Birrës në Korçë, duke vendosur një banderolë të gjatë me fjalët “Bregoviq dajre gjenocidi” në bulevardin “Republika”.

Ky aksion u organizua në solidaritet me 20 shoqatat e familjeve të personave të zhdukur gjatë gjenocidit që Serbia kreu në Kosovë, të cilat kanë kërkuar nga Bashkia e Korçës anulimin e ftesës në “Festën e Birrës” të muzikantit të shumëkontestuar Goran Bregoviq.

Aksioni u zhvillua, gjithashtu, në mbështetje të bojkotit që shumë artistë shqiptarë nga të gjitha trevat i kanë bërë kësaj feste, pasi Bashkia e Korçës ka refuzuar ta anulojë ftesën për Bregoviqin.



# Murati: Mbi 10 milionë euro janë investuar në Bonot e Diasporës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 19 gusht - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar se 10.43 milionë euro janë investuar në Bono të Diasporës. Në profilin e vet në "Facebook", Murati ka treguar se mjetet nga këto letra me vlerë do të përdoren për t'i mbështetur prodhuesit vendorë në kuadër të Masës 2.1 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. "Ky emetim u përmbyll me sukses, duke arritur shumën totale mbi 10 milionë euro në emetimin e parë. Mjetet nga Bonot e Diasporës ne do t'i përdorim për t'i mbështetur prodhuesit vendorë në kuadër të Masës 2.1 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe që tani do ta përcjell propozim-vendimin për mbledhjen e radhës të qeverisë", ka shkruar Murati.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe bankat komerciale partnere për lëshimin e bonove të Thesarit për diasporën.

Shuma totale e paraparë për këto bono është 20 milionë euro, me mundësi rritjeje deri në 50 për qind, nëse do të ketë kërkesa.

Për ata që blejnë bono të Thesarit me kohëzgjatje trevjeçare, interesin që do ta marrin do të jetë 1.2 për qind, kurse për paratë e investuara për pesë vjet, interesi do të jetë 2.2 për qind.

Kuponi i parë i interesit do të paguhet në muajin shkurt, kurse i dyti në gusht dhe kështu do të vazhdojë pagesa çdo gjashtë muaj, deri në përfundimin e marrëveshjes. Krejt në fund, kur përfundon koha e maturimit, personi që i ka lëshuar kredi shtetit, i merr të gjitha paratë e investuara.



# Mbahet debat publik në Ferizaj për ndërtimin e nënstacionit të ri të KOSTT-it

Ferizaj, 19 gusht (ER) - Nën organizimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në ambientet e Kuvendit Komunal të Ferizajt si dhe përmes platformës online zoom është mbajtur debat publik për çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 me infrastrukturë përcjellëse.

Në debatin publik në të cilin ishin të ftuar qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe të komunës së Ferizajt u paraqit raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) për këtë projekt, me ç'rast të gjitha palëve të interesuara u është ofruar mundësia që të parashtrojnë pyetje për çështje me interes në lidhje me projektin.

Raporti i VNM-së për këtë projekt i cili është paraqitur, duke i konsideruar të gjitha ligjet dhe procedurat relevante sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ka pasur për qëllim identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis si rezultat i këtij projekti si dhe identifikimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale.

Në bazë të analizës së paraqitur përmes raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin kapital të KOSTT-it për ndërtimin e nënstacionit të ri 110 kV Ferizaj 3, u konstatua që implementimi i këtij projekti nuk ka efekte të dëmshme domethënëse për mjedisin.

Implementimi i projektit do të ketë ndikim pozitiv sa i përket krijimit të kushteve për furnizim cilësor me energji elektrike për qytetarët e komunës së Ferizajt nga aspekti i transmetimit si dhe do të ndikojë në hapjen e një perspektive të re për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në këtë komunë.



## Anulimi i dasmave, Sogojeva: Pritet të ketë rreth 400 milionë euro më pak qarkullim

Prishtinë, 19 gusht - Me vendimin e ri të qeverisë për ndalimin e dasmave dhe ahengjeve në tregun e Kosovës për vetëm dy javë pritet të qarkullojnë rreth 400 milionë euro më pak. Drejtuesit e Odës së Hotelerisë dhe Turizmit vlerësojnë se në rast se nuk do të kishte një vendim të tillë qarkullimi do të shkonte në mbi 1 miliard euro. Kryetari i OHT-së, Hysen Sogojeva, ka thënë se ky vendim ka lënë pa realizuar rreth 40 për qind të dasmave të planifikuara, teksa shton se dëmi, i cili arrin vlerën prej rreth 400 milionë eurove, është jashtëzakonisht i madh.





# 'Lamtumirë Gabo dhe Mercedes' – Dashuria në kohërat e famës

## Kujtimet e të birit për humbjen e prindërve të tij dhe fundin e një epoke në letërsinë kolumbiane

**Nga Boyd TONKIN**
**Wall Street Journal**

Mercedes Barcha-s i pëlqente t'u rikujtonte dy djemve të saj që "ne nuk jemi figura publike". Burri i saj këmbëngulte gjithmonë që "çdokush ka tri jetë: atë publike, private, dhe të fshehtë". Fëmijët e tyre u rritën në një shtëpi ku "vija mes publikes dhe privates" ruhej rreptësisht. Sidoqoftë, Rodrigo Garcia, djali i madh i Mercedes-it dhe Gabriel García Márquez-it, tashmë ka shkruar një kujtim të hollë, personal mbi ditët e fundit të një prej çifteve letrare më të njohura të planetit.

Laureati kolumbian i Nobelit i cili shkroi "Njëqind vjet vetmi", "Dashuria në kohërat e kolerës" dhe vepra të tjera që rikonturuan edhe hartën kulturore të Amerikës Latine dhe konturet e trillimit modern, vdiq në shtëpinë e tij në Mexico City në Prill 2014. Ishte 87 vjeç. Pas një miqësie të gjatë, ai u martua me Mercedes Raquel Barcha Pardo në Barranquilla në 1958. García Márquez pohon se e ka takuar fillimisht rreth 1941 kur ajo – po ashtu si ai, fëmija i një farmacisti nga qytetet përvëlues të bregut të lumit Magdalena – ishte 9 vjeç dhe ai 14. Në fillimet e 1945, ai kompozoi një sonet për nxënësen me prejardhje pjesërisht egjiptiane të cilën e lëvdoi si "herët në mëngjes / po aq e pabesueshme sa çdo histori".

Martesa do të vononte më shumë se një dekade: Bashkimi i tyre do të zgjaste deri në vdekjen e tij. Për Gerarld Martin, biografi i autorizuar i Gabriel García Márquez, Mercedesi i solli "freski dhe metodë jetës së tij" dhe i imponoi "ndjenjën e saj legjendare të rendit" në punëtorinë e tij krijuese. Ajo vetë vdiq në gusht 2020. Vdekja e saj e shtyu Rodrigo Garcia-n, lindur në 1959 në Bogotá (kryeqytetin gri, malësor e me shi të Kolumbisë, të cilin babai i tij karaibian e kishte kaq shumë inat) që të shkruante për prindërit e tij. Ose më mirë, të evokonte javët e fundit të babait të tij si një invalid i goditur nga kanceri, me kujtime joshëse mbi të kaluarën e tyre të përbashkët.

Z. Garcia është një shkrimtar-regjisor-producent i bazuar në Los Angeles: Veprat e tij përfshijnë filmat "Albert Nobbs" dhe "Last Days in the Desert" si dhe serialin e HBO-së "In Treatment". Në shtyp, ai paraqet skena të shkurtra, nga afër, të një shtëpie të zënë të një burri duke vdekur, të mbushur me kujdestarë dhe familjarë. Zëri i z. Garcia mbetet i butë dhe modest, sytë e tij të qëndrueshëm, stili i tij mrekullisht pa zbukurime. Ai vështron më shumë seç reflekton. Vetëm një episod të kujton paksa atmosferën e ethshme, ekstravagante dhe të çuditshme të trillimeve më të njohura të babait të tij, kur një zog përplaset me murin prej xhami të verandës. Ogur i mirë apo i keq? Stafi i shtëpisë nuk bie dot dakord. Sidoqoftë, trupi i tij i pajetë bashkohet me një papagall dhe një këlysh në ngastrën e varrezave të kafshëve për të cilën romancieri i përndjekur nga vdekja nuk dinte gjë (ai "do të ishte shqetësuar prej kësaj").

Gerald Martin e pa ngurrimin e hekurt publik me të cilin "Gabo" dhe Mercedesi ruanin martesën e tyre si "një lojë e luajtur mes dy njerëzve shumë të fortë, shumë ironikë dhe shumë privatë." Dashuria e tyre jetëgjatë shfaqet rrallëherë në kujtimet "Jeto për ta treguar" që García Márquez botoi më 2002 (në shqip: Onufri, 2016), pas një periudhe të vështirë me kancerin. Edhe ndërkohë që ai sheh babain e tij tek merr lejen e fundit, z. Garcia përpiqet të respektojë privatësinë e tyre. Nuk marrim exposé spektakulare por pak shkrepje devijuese, ndërkohë që Gabo i bën një tribut të papritur Elton John-it (atij "boleristi të pabesueshëm") ose bën shaka me infermieret e mbledhura "No me las puedo tirar a todas" (S'mund t'ju palloj dot të gjithave). Z. Garcia përpiqet t'i shmanget "tundimit për të rritur famën vetjake në kohën e vulgarizimit", ndërkohë që kamerat grupohen në derën e jashtme. "Duhet të jemi të përgatitur pasi do të jetë si në kopsht zoologjik," paralajmëron Mercedesi Rodrigon. Është – megjithëse miqësor".

Nëse portreti fragmentar i të birit për Gabo-n zbulon pak gjë, Mercedes-i – "e hapur dhe e fshehtë, kritike dhe shpirtmadhe, por që i druhej rrëmujës" – na shfaqet në intervale nga pas maskës së kompetencës të çeliktë e të shkathët që gjen dhe në përshkrime të tjera. Një skenë nga dasma e saj tregon pasiguritë e hershme: Mercedes-i nuk u vesh derisa Gabo arriti në kishë, "që të mos kishte shans të braktisej në altar e veshur me fustanin e nusërisë".

"Lamtumirë Gabo dhe Mercedes" godet notën e tij të trishtimit jo falë ndonjë dramaticiteti në shtratin e vdekjes – Gabo ndërron jetë qetësisht dhe në heshtje. Përkundrazi, shqyrtimi pas fakteve i z. Garcia mbi punën e vështirë të vdekjes e lejon peshën e humbjes të mblidhet thuajse pa u parë derisa bie si një gur mbi të mbijetuarit. Pasi vdes Gabo, Mercedes hyn në dhomë për të marrë punët në dorë, si përherë, por shikon në fytyrën e të "pobrecito" (shkretit) dhe, siç nuk bën kurrë, qanë pak. Lotët e saj të menjëhershëm kanë forcën e breshërisë së një automatiku". Nuk ka asgjë tragjike për këtë vdekje të parathënë të një 87-vjeçari të nderuar i cili ka shijuar "një nga jetët më fatlume dhe më të privilegjuara të jetuara ndonjëherë nga një latino-amerikan" – përveç mungesës së tij të plotë. "Qué barbaridad," vajton agjentja e tij e përkushtuar, Carmen Balcells. Çfarë barbariteti, vërtet, që një mendje e tillë të shuhet ndonjëherë. Kur e ndjek nga pas dhe Mercedes-i, z. Garcia e lidh vdekjen e prindit të dytë më zhdukjen e një planeti nga qielli. ("Ai është zhdukur, bashkë me fenë, shprehitë, zakonet dhe ritualet e tij të veçanta, të mëdha apo të vogla".) Lexuesit e rinj të Gabriel García Márquez-it ndonjëherë vijnë te librat e tij në kërkim të ekzotikes, fantastikes, të huajës. Ata qëndrojnë për të njerëzishmen, intimen, universalen. Po kështu, "Lamtumira" e z. Garcia, të prek kur del butësisht nga jeta publike në atë private për të na treguar mbylljen e njohur të kësaj bashkëjetese unike. Sa për jetën sekrete, e cila banon diku tjetër – e sigurt në artin e pakrahasueshëm të babait të tij.

Përktheu E. H.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisim Prerje

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Atanda, pas transferimit te Prishtina: Në Kosovë ndihem si në shtëpi




PRISHTINË, 19 GUSHT - Qendërmbrojtësi korpulent Sodiq Ololade Atanda, i lindur në Nigeri dhe me pasaportë shqiptare, nënshkruan me kampionen aktuale të Kosovës, Prishtina. Futbollisti 27-vjeçar, pas përvojës disavjeçare në futbollin shqiptar dhe ndërkombëtar, gjegjësisht në atë izraelit te Hapoel Kfar Saba, arrin marrëveshje për bashkëpunim me kampionen aktuale të Kosovës, FC Prishtina. "Unë si pjesë e këtij klubi pres të fitoj edhe më tutje përvojë duke rifilluar prej aty ku u transferova dhe shpresoj që do t'i jap klubit mbështetjen time maksimale për të shkuar sa më lart karshi pritshmërive tona dhe unë do të isha krenar që bashkë me shokët e ekipit të korrim sukses në këtë sfidë të re dhe kampionat të ri. Jam tejet i lumtur që vij këtu sepse ndihem si në shtëpi ngaqë Kosova është afër Shqipërisë dhe, siç e dini, unë jam me pasaportë shqiptare dhe kisha përvojë të jashtëzakonshme gjatë qëndrimit tim atje. Mezi pres që të takohem edhe me tifozët tanë, të cilëve dëshiroj t'u tregoj se çfarë jam i gatshëm të bëj këtu për ekipin tonë, duke dhënë 100 %-shin e kapacitetit tim, me punë dhe përkushtim", ka thënë Atanda, i cili ka luajtur për 36 Lions (2010-2012), Apolonia (2013-2015), Partizani (2015-2019) dhe Hapoel Kfar Saba (2019-2021). Ai ishte pjesë e Kombëtares U23 të Nigerisë.

### Feronikeli transferon 12 futbollistë

Skuadra e Feronikelit është përforcuar me 12 futbollistë. FIFA ia ka mundësuar tregun e transferimeve skuadrës nga Drenasi, pasi kjo e fundit do të paguajë me këste borxhin ndaj Bedri Grecës. Futbollistët që do të djersitin fanellën e "Niklit" në kampionatin e ri janë Behar Maliqi, Berat Ahmeti, Dren Gashi, Alban Shabani, Azem Bejta, Lulzim Doshlaku, Qemail Elshani, Diar Prokshi, Endrit Kastrati, Granit Musa, Drilon Leku dhe Labinot Jashanica.

## SHKURT

### Zeqiri përforcon Prishtinën

Jetmir Zeqiri sezonin e ardhshëm do të jetë pjesë e Sigal Prishtinës. Pas Lejsonit edhe Jetmiri në sezonin e ardhshëm do të jetë pjesë e bardhë e kaltërve. Jetmiri është i gjatë dy metra dhe aktivizohet në pozitat 3/4. Zeqiri vjen me mjaft përvojë nga Superliga e Maqedonisë si dhe pas dy vjetëve tejet të suksesshme me skuadrën e Pelisterit. Duhet cekur që skuadra e Pelisterit ishte lidere në pjesën e rregullt të kampionatit derisa u eliminua në gjysmëfinale nga skuadra e MZT Skopje e cila u shpallë më pas kampione. Zeqiri në edicionin që sapo lamë pas luajti me një mesatare prej 7.7 pikëve dhe kishte vetëm 9 paraqitje për shkak të lëndimit, derisa një edicion më herët luajti me një mesatare prej 11.5 pikëve e 6.1 kërcimeve për ndeshje.

### Mustafi arrin marrëveshje me Torinon

Shkodran Mustafi ka vendosur të rikthehet përfundimisht në futbollin italian. Mbrojtësi shqiptar tani e dy muaj është pa skuadër dhe i lirë të nënshkruajë me ndonjërën nga ekipet e interesuara. Pas largimit nga Schalke, Mustafi duket se do të rikthehet në elitën e futbollit italian, ku tani është në bisedime me Torinon. Trajneri Juriç është në kërkim të një mbrojtësi dhe palët janë shumë afër marrëveshjes. Torino i ka ofruar Mustafit një kontratë trevjeçare me shqiptarin që është bindur për t'u rikthyer në Serinë A, ku më parë ka luajtur për Sampdorian. Te Torino mbrojtësi shqiptar do të gjejë bashkëkombësit e vet Mërgim Vojvoda, Etrit Berisha e Altin Kryeziu. Interesim për Mustafin kishin shprehur edhe skuadra të tjera si Genoa, Celta Vigo, Fiorentina e Levante, por pa gjetur një marrëveshje.

### Drenica transferon Avdullin dhe Arrabalin

KF Drenica ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me dyshen e Arbërisë, Qlirim Avdulli dhe Bruno Arrabal Passamani. Mbrojtësi Avdulli është bashkuar me skuadrën kuqezi, ndërsa Arrabal do të bashkohet sapo ta kompletojë dokumentacionin. "Skuadra në ditët e fundit të afatit kalimtar ka arritur marrëveshje me mbrojtësin e krahut të majtë, Qlirim Avdulli. Lojtari ferizajas do t'i mbrojë ngjyrat kuq e zi, pasi ka nënshkruar kontratë njëvjeçare, me mundësi vazhdimi. Lojtari më parë ishte bashkuar me ekipin dhe është i gatshëm për edicionin e ri që do të nisë këtë fundjavë. Ndërkohë mesfushori me tipare mbrojtëse, Bruno Arrabal Passamani, ka nënshkruar kontratë me klubin deri në përfundim të edicionit 2021/22. I njëjti do të bashkohet me skuadrën sapo ta kompletojë dokumentacionin, pasi lojtari momentalisht gjendet në Brazil", thuhet në njoftimin e KF Drenica. Ndeshjen e parë skuadra kuqezi nga Skenderaj do ta zhvillojë kundër SC Gjilani.

## Sot hidhet shorti për Kosovën A



PRISHTINË, 19 GUSHT - Sot (e premte) në Gjermani do të hidhet shorti për rrethin e parë parakualifikues të FIBA Eurobasket 2025, ku do të mësohen edhe kundërshtarët e Kosovës A në konkurrencën e meshkujve. Në short do të jetë i pranishëm drejtori i përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova. Shorti do të hidhet nga ora 11:45, ku "dardanët" do të mësojnë kundërshtarët me të cilët do të ballafaqohen. Pas hedhjes së shortit do të bëhen të ditura edhe datat se kur do të luajë Kosova A te meshkujt.

## Joshua: Usyku do të shijojë humbjen e parë

LONDËR, 19 GUSHT - Boksieri britanik Anthony Joshua u shpreh se do të zbrazë gjithë arsenalin dhe fuqinë e tij në duelin e 25 shtatorit ndaj ukrainasit Oleksandr Usyk, sfidë e vlefshme për titujt kampionë bote në peshën e rëndë (WBA, WBO, IBF). Kjo përballje do të zhvillohet në stadiumin e Tottenhamit në Londër. Joshua synon t'i shkaktojë Usykut humbjen e parë në karrierë. "Dueloj për të mbrojtur titujt kampionë bote dhe nuk kam ndërmend t'i lëshoj. Usyk nuk ka asnjë shans të fitojë dhe në ring do ta provojë forcën time, fuqinë e grushteve të mia. Po përgatitem mirë për këtë sfidë", ka deklaruar Joshua. Usyk, ish-kampion bote në peshën "cruiserweight", synon titujt kampionë edhe në peshën e rëndë. "Ai nuk grushton mjaftueshëm fort për këtë Divizion, ku gjithçka është ndryshe. Unë nuk nënvlerësoj askënd, por nuk kam frikë nga askush. Usyk do të provojë dhimbjen e humbjes së parë", ka deklaruar Joshua.



# Latifi: Vllaznia me suksese mund të bëhet si Skënderbeu

SHKODËR, 19 GUSHT - Goditja më e madhe në merkato e klubit shkodran, Liridon Latifi, duket se po merr veten plotësisht dhe është gati për të nisur një sezon me pritshmëri të larta me fanellën kuqeblu. Në një intervistë ekskluzive për "Panorama Sport", 27-vjeçari që u rikthye në Kategorinë Superiore pas katër vjetëve mes Hungarisë dhe Moldavisë, në klube si Pushkash dhe Sherif Tiraspol, tregon pse bëri këtë zgjedhje dhe pikërisht vendimin për të luajtur me Vllazninë. Edhe pse e shikon të vështirë, ai beson se klubi shkodran mund të hapë një cikël fitues dhe të bëhet si Skënderbeu i artë, ku Latifi shkëlqente deri në vitin 2018. Sulmuesi i krahut beson se me paraqitjen që do të bëjë këtë sezon me Vllazninë, do të grumbullohet sërish nga Kombëtarja shqiptare.



*Liridon, goli i parë për ju me fanellën e Vllaznisë vjen në një miqësore. A ka diçka të veçantë që kërkoni ta ndani me lexuesit e gazetës?*

**Latifi:** Po, sepse unë jam bërë baba javën e kaluar dhe normalisht që ky gol i parë shkon për djalin e sapolindur. Pavarësisht se ishte thjesht një miqësore, sërish mund të them se ishte një ndeshje e vështirë për ne, pasi vijmë nga stërvitje me shumë ngarkesa. Ishte një fitore e ëmbël për mua dhe tashmë po përgatitemi për finalen e Superkupës me Teutën.

*Riktheheni në kampionatin shqiptar pas katër vjetësh, atëherë kur tifozët mbajnë mend një Latif në superformë. Mendoni se mund të jetë ky sezoni që do të rikapni formën që keni pasur dikur?*

**Latifi:** Shpresoj që po. Jam duke punuar për këtë por, siç e patë edhe ju, në miqësoren e fundit isha jashtëzakonisht i lodhur për shkak të ngarkesave të mëdha që kam pasur së fundmi, por unë besoj shumë se do të vij në ditët e mia më të mira.

*Sa shanse ka që Vllaznia të bëjë atë që bëri Skënderbeu, duke hapur një cikël fitues?*

**Latifi:** Po, ka shumë shanse. Normalisht nuk është asgjë e pamundur që Vllaznia të ketë një cikël fitues. Unë mendoj se siç është duke u ndërtuar skuadra më pëlqen shumë dhe mund të jemi një grup me mentalitet fituesi.

*Në sezonin e kaluar Vllaznisë i iku titulli kampion nga duart vetëm për shkak golavarazhi. Si e shikoni tashmë skuadrën në krahasim me rivalët?*

**Latifi:** Normalisht që e shikoj pretendente Vllazninë, pasi presidenti ka punuar në këtë drejtim dhe uroj që të ketë edhe ndonjë afrim të ri. Unë shpresoj shumë se do të dalim aty ku po mendojmë.

# Lewandowski dëshiron një sfidë të re, Bayerni kërkon 120 milionë

Munchen, 19 gusht - Robert Lewandowski dëshiron të provojë një sfidë të re larg nga Bayern Munchen, por mund të jetë i detyruar të qëndrojë në Gjermani, pasi klubi bavarez nuk pranon ta lërë të largohet për më pak se 120 milionë euro. Kështu raporton "Sky Sports News", duke cituar burime pranë 33-vjeçarit. Sipas medias britanike, sulmuesi polak është i lumtur në Munchen, ku ka një kontratë deri në vitin 2023, por dëshiron të largohet para kohe, pasi deri atëherë do të ketë arritur në moshën 35-vjeçare dhe do ta ketë të vështirë të sigurojë një kontratë me një skuadër tjetër të madhe. Bayern nuk i ka propozuar, të paktën deri tani, një rinovim të kontratës, por as nuk pranon të negociojë për një çmim më tërheqës, çka ka mërzitur lojtarin. Lewandowski vlerësohet gjerësisht si një prej lojtarëve që përkushtohet më shumë për gjendjen fizike, pasi dëmtohet shumë rrallë. Gjithashtu, është një makineri golash, për të cilën shumë skuadra do të kishin nevojë.



## SHKURT

### Thyhet tabuja 40-vjeçare, Pedro nga Roma kalon te Lazio

Ka marrë fund pritja 40-vjeçare dhe tashmë zyrtarisht një futbollist i Romës ka kaluar te skuadra tjetër e kryeqytetit, Lazio. Pedro Rodrigez u është bashkuar bardhekaltërve pas një sezoni të kaluar me Romën, ku shënoi 5 gola dhe dhuroi një asistim. 34-vjeçari do të mbajë numrin 9 dhe është paraqitur nga vetë faqja e klubit në "Twitter". Tare arrin të thyejë kështu një tabu 40-vjeçare ndërmjet të dyja ekipeve që kur transferuan për herë të fundit Karlo Perronin nga Lazio te Roma në vitin 1981.

### Bayerni konfirmon lëndimin e Neuerit

Një goditje vërtet e madhe për Bayern Munchenin në këtë fillim të sezonit të ri teksa skuadra "bavaraze" ka humbur portierin dhe kapitenin e skuadrës Manuel Neuer për shkak lëndimit. 35-vjeçari u dëmtua në kyçin e këmbës së djathtë në finalen e Superkupës ndaj Borussia Dormundit, por arriti ta mbyllte ndeshjen pa u zëvendësuar. Lajmi u bë publik ditën e sotme nga vetë faqja e Bayernit duke hidhëruar tifozët "bavarezë". Një prishje planesh për Julian Nagelsman i cili humbet lojtarin më të rëndësishëm në skuadër në këtë start sezon, teksa nuk bëhet e ditur koha që do të mungojë kapiteni i kombëtares gjermane. Me shumë mundësi Neuer do të humbasë edhe ndeshjen e parë në grupet e Ligës së Kampionëve.

### Gazetari spanjoll: Haalandi ka marrëveshje me Realin

Sulmuesi Erling Haaland është një ndër emrat më të përfolur në dy merkatot e fundit. Lojtari i Borussia Dortmundit kërkohet nga top klubet evropiane me një interesim më të madh nga Real Madridi. Gazetari spanjoll Siro Lopez ka raportuar se Real Madridi ka arritur marrëveshje me norvegjezin dhe ai do të transferohet në 2022-n te "Galaktikët". Kylian Mbappe mendohej të ishte objektivi kryesor i Carlo Ancelottit, mirëpo gjërat kanë ndryshuar pas transferimit të Lionel Messit në klubin parisien. Lopezi konsiderohet si një burim i sigurt për raportimet mbi Real Madridin.

### Fury 'izolohet' para meçit me Wilderin

Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC), përmes një postimi në rrjetet sociale ka bërë me dije se deri më 10 tetor, kur do ta zhvillojë duelin ndaj Deontay Wilder, nuk do të bëjë më asnjë postim.
Fury, i pamposhtur në karrierën e tij (30 fitore, 1 barazim), u shpreh se do të fokusohet vetëm te stërvitja, për ta mposhtur sërish rivalin amerikan. Pikërisht në duelin e shkurtit 2020 britaniku fitoi me KO, duke i shkaktuar Wilderit humbjen e vetme në karrierë. "Miq, do të jem 'offline' deri më 10 tetor. Dikush tjetër do t'ju mbajë të informuar. Për mua 'blackout' total. Do të shihemi në Las Vegas. Le të nisë loja. 7 javë përgatitje për të mposhtur sërish Wilderin. Zoti na bekoftë!", ka qenë komenti i Tyson Fury.

## Liverpooli nuk e pranon ofertën e Lyonit për Shaqirin

Lyoni po tenton transferimin e Xherdan Shaqirit. Drejtuesit e klubit francez kanë arritur prej ditësh pajtimin me lojtarin me origjinë shqiptare, por Liverpooli nuk po bindet ta lë të lirë. "The Reds" kërkon 14 milionë euro për kartonin e sulmuesit të kombëtares zvicerane, i cili është gati të nisë një aventurë të re pas tre vjetëve të kaluara në "Anfield". "The Athletic" shkruan se klubi francez ofron vetëm 6 milionë euro momentalisht për Shaqirin. Diferenca është e madhe, por Lyoni po përgatit një tjetër propozim për Liverpoolin. Drejtuesit e klubit të Ligës 1 janë shumë afër shitjes së Cornet te Norwichi. Më pas sulmi final për Shaqirin, sigurisht me një ofertë më të mirë se 6 milionë euro.a

**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo**
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
**Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo**

## Njoftim për tatimpagues

## ATK verifikon mallrat pa origjinë

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë tatimpaguesit se në bazë të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kërkohet dokumentimi i origjinës së mallit.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te tatimpaguesit, të cilët posedojnë mallra pa origjinë.

Secili tatimpagues duhet të ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së tatimpaguesit.

Po ashtu, secili tatimpagues duhet të dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, shkëmbimit apo mënyrave tjera) deri sa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër.

ATK, inkurajon të gjithë tatimpaguesit që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Administrata Tatimore e Kosovës

**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo**
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
**Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo**

## Notice to taxpayers

## TAK verifies goods without origin

The Tax Administration of Kosovo reminds all taxpayers that, according to Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures, documentation of the origin of the goods is required.

TAK activities will be continuously focused on taxpayers who possess goods without origin.

Each taxpayer must provide supporting documentation, which justifies the origin of the goods both at the location, or locations of the taxpayer, as well as for goods in circulation outside the location of the taxpayer.

Also, each taxpayer must document all goods from the time of receipt (whether through import, purchase, exchange or other means), until they are sold or otherwise systematized, including sales documentation or other systematization.

TAK encourages all taxpayers to respond correctly to tax liabilities, otherwise TAK will be forced to take punitive measures, according to tax legislation.

By fulfilling your tax obligations, you will contribute directly to the financing of government programs such as: the provision of public services, education with high standards, health and social welfare, legal protection and security, as well as general infrastructure for a better economic and social welfare.

Tax Administration of Kosovo

**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo**
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
**Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo**

## Obaveštenje za poreske obveznike

## PAK verifikuje robu bez porekla

Poreska uprava Kosova podseća sve poreske obveznike da prema Zakonu br. 03 / L-222 o poreskoj administraciji i postupcima, potrebna je dokumentacija o poreklu robe.

Aktivnosti PAK-a biće kontinuirano usmerene na poreske obveznike koji poseduju robu bez porekla.

Svaki poreski obveznik mora da obezbedi prateću dokumentaciju koja opravdava poreklo robe kako na lokaciji, tako i na lokaciji poreskog obveznika, kao i za robu u prometu van lokacije poreskog obveznika.

Takođe, svaki poreski obveznik mora dokumentovati svu robu od trenutka prijema (bilo uvozom, kupovinom, razmenom ili drugim sredstvima) do prodaje ili sistematizacije na drugi način, uključujući prodajnu dokumentaciju ili drugi sistem.

PAK podstiče sve poreske obveznike da pravilno odgovore na poreske obaveze, u suprotnom PAK će biti obavezna da preduzme kaznene mere prema poreskom zakonodavstvu.

Ispunjavanjem poreskih obaveza, direktno ćete doprineti finansiranju državnih programa kao što su: pružanje javnih usluga, obrazovanje sa visokim standardima, zdravstvena i socijalna zaštita, pravna zaštita i sigurnost, kao i opšta infrastruktura za bolju dobrobit ekonomski i socijalni.

Poreska uprava Kosova

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Diar Qerka shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

▶ Alketa Zeqiri shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË
KIESA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria–Vlada-Government***

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë***

***Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese të kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin PLMA's U.S. Private Label Trade Show-Chicago, SHBA, me 14–16 nëntor 2021**

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e katër (4) subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 06.09.2021 dhe vetëm aplikacionet e plotësuara tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

1. Për të aplikuar duhet dorëzuar:
   1.1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
   1.2. Dokumentet e kërkuara.

2. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
   2.1. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
   2.2. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
   2.3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
   2.4. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me ivjetër se 30 ditë).
   2.5. Deklaratën nën betim;
   2.6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2020 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
   2.7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

1. Katër (4) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kritereve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
   1.1. Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt, tre (3) pikë për dy produkte, pesë (5) pikë për tri (3) produkte, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
   1.2. Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Angleze pesë (5) pikë, dhe pesë (5) pikë në gjuhë tjera evropiane;
   1.3. Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Angleze pesë (5) pikë dhe pesë (5) pikë në gjuhë tjera evropiane;
   1.4. Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë viteve 2019 dhe 2020, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së pesë (5) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) tri (3) pikë dhe tregjet e tjera dy (2) pikë;
   1.5. Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesë (5) pikë kumulative: HACCP dy (2) pikë, ISO 22000 dy (2) pikë dhe certifikim tjetër relevant një (1) pikë;
   1.6. Paraqitja e subjektit aplikues në panaire tri (3) vitet e fundit, maksimum pesë (5) pikë: një panair një (1) pikë, dy (2) panaire dy (2) pikë, tri (3) panaire tri (3) pikë, katër (4) panaire katër (4) pikë dhe pesë (5) e më shumë panaire pesë (5) pikë; dhe
   1.7. Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2020, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 23.08.2021, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, ekspertët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 06.09.2021 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësi së dhe Tregtisë, Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 12, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën export.kiesa@rks-gov.net.

AGENCIJA ZA INVESTICIJE I PODRŠKU PRODUZEĆA NA KOSOVU
KIESA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria–Vlada-Government***

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë***

***Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

U cilju promovisanja proizvođaćkih kompanija vinana Kosovu u pronalaženju stranih tržišta za izvoz, Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine preko Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima na Kosovu (KIESA) objavljuje:

**Javni poziv za apliciranje za učešće na državnom štandu Kosova na sajmu "PLMA - World of Private Label"Special Pavilion uChicago, USA, od 14–16 novembar2021**

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine, odnosno Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima KIESA koja pokriva troškove izložbenog prostora, izgradnje štanda, registracije cetiri (4) učesnika, troškove električne energije, svakodnevno čišćenje prostora itd., dok putovanje, smeštaj, hrana, isporuka promotivnih materijala će biti preuzete od strane ućesnika.

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja poslata do 06.09.2021 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

1. Da biste aplicirali treba dostaviti:
   1.1. Aplikaciju popunjenu osnovnim podacima subjekta koji aplicira; i
   1.2. Potrebne dokumente.

2. 2. Potrebni dokumenti za apliciranje:
   2.1. Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
   2.2. Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
   2.3. Kopija lične karte ovlašćenog lica aplikanta;
   2.4. Uverenje Suda da ovlašćeno lice subjekta nije pod istragom (potreban je original, ne stariji od 30 dana);
   2.5. Izjava pod zakletvom;
   2.6. Potvrda godišnjeg prometa aplikanta za fiskalnu godinu 2020 od strane Poreske Administracije Kosova; i
   2.7. Poresko uverenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog dokumenta koji se zahteva na gore navedenoj listi, aplikacija aplikanta će biti diskvalifikovana i neće se dalje razmatrati za specifične kriterijume navedene u nastavku.

1. Cetiri (4) učesnika bit će odabrano prema sledećim specifičnim kriterijumima i tačkama rangiranja:
   1.1. Proizvode koje će aplikant pružiti potencijalnim kupcima na sajmu, maksimalnodeset (10) poena: jedan (1) poen za jedan (1) proizvod, tri (3) ) poena za dva proizvoda, pet (5) poena za tri(3) proizvoda, sedam (7) poena za četiri (4) proizvoda i deset (10) poena za pet (5) ili više proizvoda;
   1.2. Poznavanje stranih jezika i veština prezentacije predstavnika subjekta koji učestvuju na sajmu, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: Engleski jezik pet (5) poena, i drugi jezici pet (5) poena;
   1.3. Promotivni materijali na stranim jezicima, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: na Engleskom jeziku pet (5) poena, i pet (5) poena na drugim Evropskim jezicima;
   1.4. Države u kojima su proizvodi aplikanta izvezenitokom 2019 i 2020, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: države članice EU pet (5) poena, države Zapadnog Balkana koje nisu članice EU (Albanija, Bosna i Hercegovina, Srbija, Crna Gora i Makedonija) tri (3) poena i druga tržišta dva (2) poena;
   1.5. Međunarodna sertifikacija aplikanta, maksimalno pet (5) kumulativnih poena: HACCP dva (2) poena, ISO 22000 dva (2) poena i druge relevantne sertifikacije jedan (1) poen;
   1.6. Prezentacija aplikanta na sajmovima u poslednje tri (3) godine, maksimalno pet (5) poena: jedan sajam jedan (1) poen, dva (2) sajmova dva (2) poena, tri (3) sajmova tri (3) poena, ćetiri (4) sajmova ćetiri (4) poena i pet (5) i više sajmova pet (5) poena;
   1.7. Godišnji promet aplikanta tokom fiskalne godine 2020, maksimalno deset (10) poena: od nule do 500.000 evra četiri (4) poena; od 500.001 do 1.000.000 evra osam (8) poena i preko 1.000.000 evra deset (10) poena;

Dana 23.08.2021,u 14:00 ćasova, u sali za sastanke KIESA, službenici KIESAće odgovoriti na pitanja o sajamskoj organizaciji i podršci kompanijama za učešće na ovom sajmu. Subjektima kojima je potrebna asistencija u popunjavanju ovog obrasca savetuje se da takođe prisustvuju ovom sastanku.

Subjekti koji žele da apliciraju za učešće na sajmu treba da izraze svoje interesovanje popunjavanjem aplikacije i poslati najkasnije do 06.09.2021 u kancelariji Arhive Ministarstva Industrije, Preduzetnistva i Trgovine, Ulica: "Arbënor e Astrit Dehari", no. 12, 10000 Priština, Republika Kosovo.

U trenutku apliciranja, subjekat prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterije i dužnosti predviđene važećim zakonima i posebnim kriterijumima predviđenim u ovom javnom pozivu.

Informacije i upitnik za izražavanje interesovanja mogu se dobiti na KIESA-MTI ili preuzeti sa veb stranice mti.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net ili na e-mail adresi export.kiesa@rks-gov.net.

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"
10 000 Prishtinë Rr.ULPIANA U1/1 pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereze.org e mail:ntereze@yahoo.com

# CONTRACT AWARD NOTICE

**SERVICES**

*According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092*

**Date of the preparation of the Notice: 19/08/*2021***

| Procurement No | Mentoring | 003 | 2021 | 221 |
|---|---|---|---|---|

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

**English** ☒

**SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY**

**I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)**

| | | |
|---|---|---|
| **Official name**:Kosovo Humanitarian Charitable Society " Mother Teresa" | | |
| **Postal address**: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1 | | |
| Town:*Prishtina* | Postal code:10000 | Country:Kosovo |
| **Contact point(s)**: Zef Shala | Telephone:044-128-277 | |
| Email:zefshala@hotmail.com | Fax:038-542-865 | |
| Internet address (*if applicable)*: | www.matherteresasociety.org | |

**SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT**

**II.1) DESCRIPTION**

**II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:**
**"Mentoring and Coaching for 400 previous beneficiaries-returnees"**

**II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance**
*(Chooseone category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)*

| | | |
|---|---|---|
| | | ☒Services |
| | | Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities |

**II.1.4) Short description of the object of the contract**
**"Mentoring and Coaching for 400 previous beneficiaries-returnees"**

**II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)**
**93.000.000.-8**

*Standard Form "Contract Award Notice"* 1

**II.1.6) Division into lots** **NO** ☒

**II.1.7) Contract value: 95,680.00 Euro**

**SECTION III: PROCEDURE**

**III.1) TYPE OF PROCEDURE**

☐ **Open**

**III.2) AWARD CRITERIA**

☐ **Lowest Price**

**III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION**

**SECTION IV: AWARD OF CONTRACT**

*(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)*

**IV.1) Date of contract award 19/08/2021**
**IV.2) Intended date of contract signing 27/08/2021**
**IV.3) Number of received tenders 3**
**IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded**

| | | |
|---|---|---|
| **Official name: "SMART INOVATION CENTRE"-SIC Prishtinë** | | |
| **Postal address**: 10000 Prishtinë | | |
| Town:*Prishtinë* | Postal code:10000 | Country: Kosovo |
| URL (*if applicable)*: | | |
| **Contact point(s)**: **Xhyljeta Luzha** | Email: **info@sic-kos.com** | |
| Telephone: **+383 44/45 817477** | Fax: **+38338748701** | |

**IV.5) Information on value of contract**

**Total final value of contract 95,680.00 Euro**
Responsive tender with lowest price: 95,680.00 Euro_
Responsive tender with highest price:1112,000.00 Euro_

**IV.6) The contract is likely to be subcontracted** **No** ☐

**SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION**

**V.1) COMPLAINTS**

**Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 ,at the address specified in Section I of this Contract award notice.**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice*

AAPSK

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencija za Upravljane Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

## Ftesë për Ankand Publik

**Datë 19.08.2021** **Referenca: AAPSK - 005/2021**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

| Nr | Përshkrimi | Sasia/copë | Çmimi Fillestar/copë | Çmimi nga ofertuesi | Çmimi total € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BMW 330I, viti i prodhimit 2007,benzin,ngjyre e hirit metalike me targa vendore-Rishpallje | 1 copë | 6,750.00 € | | |
| 2 | Audi 80, viti i prodhimit 1987,benzin,ngjyre e bardhe-për skrap | 1 copë për skrap | 157.50 € | | |
| 3 | Kamionet Mercedes-Benz 316 CDI, viti i prodhimit 2006,dizel, ngjyre e bardhe me targa te huaja | 1 copë | 5,000.00 € | | |
| 4 | BMW 520, viti i prodhimit 2002,dizel,ngjyre e zeze-për skrap | 1 copë për skrap | 359.85 € | | |
| 5 | Mitsubishi L200, viti i prodhimit 1995,dizel,ngjyre e gjelbër-për skrap | 1 copë për skrap | 603.75 € | | |
| 6 | Jeep Cherokee, viti i prodhimit 1992, dizel, ngjyrë e gjelbër - për pjese | 1 copë për pjesë | 800.00 € | | |
| 7 | Mercedes Benz E220D, viti i prodhimit 1998,dizel,ngjyre e zeze me targa vendore | 1 copë | 1,800.00 € | | |
| 8 | VW Golf II, viti i prodhimit 1987, benzin, ngjyrë e kuqe - për skrap | 1 copë për skrap | 205.16 € | | |
| 9 | BMW M3, viti i prodhimit 1993,benzin,ngjyre e zeze-për skrap | 1 copë për skrap | 307.28 € | | |

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 26.08.2021 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 26.08.2021, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.
Pasurit e konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: https://md.rks-gov.net/ Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.
Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19; MBANI DISTANCËN DHE DEZINFEKTONI DUART RREGULLISHT!

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "GT SERVICES" L.L.C. Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 810157968 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "GT SERVICES" L.L.C. Mitrovicë donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810157968 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "GT SERVICES" L.L.C. Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 810157968 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues